

V E N D I M
Nr.553 datë 16.10.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.438, DATË
14.8.1995 “PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE SHETËTËRORE TË
TRANSFORMUARA NË SHOQËRI TREGTARE”**

Këshilli i ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.438, datë 14.8.1995, pika 5, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Punonjësit e shoqërisë që privatizohet, si dhe ish-punonjësit e tyre që kanë përfituar nga legjislacioni për përkrahjen sociale, ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore nga zbatimi i reformës ekonomike, kanë të drejtë që sipas dëshirës së tyre të marrin pjesë në ankand duke kërkuar aksione të shoqërisë ku ato kanë punuar ose punojnë, për të gjithë shumën e bonove të privatizimit përfituar sipas dekretit “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit” me ndryshimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 14 gusht 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi